

Te nderuar pjesemarres !

Mirese kini ardhur ne kete takim konsultativ per menaxhimin e integruar te rezervave ujore ne basenin e Drinit qe organizojne sot Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, ne bashkepunim me UNECE dhe Global Water Partnership. Qellimi I ketij takimi eshte te shkembeje informacione nga autoritetet locale dhe aktoret nderkombetare per gjendjen konkrete te manaxhimit te rezervave ujore ne seicilin vend, te degjoje opinionet, interesat dhe nevojat nga te gjitha aktoret, te identifikojte sfidat dhe te mundesoje bashkerendimin e forcave dhe te mjeteve per nje bashkepunim te fuqishem nderkufitar per mbrojtjen mjedisore dhe nje zhvillim te qendrueshem te ketij baseni I cili duke filluar nga liqenet e Prespes dhe duke perfunduar me lumin Buna, duke lidhur mjedisin dhe ekonomine e Greqise, Maqedonise, Kosoves, Malit te Zi dhe Shqiperise duhet te konsiderohet si nje ekosistem I vetem dhe me rendesi te madhe per rajonin dhe me gjere.

Shqiperia eshte e pasur me rezerva ujore, duke pefshire ketu lumenjt, liqenet, lagunat, detet dhe ujerat nentokesore. Ne ligjin nr 8093 date 21.3.1996 “Per rezervat ujore” trajtohen **funkSIONET E UJIT :**

- Perdorime per konsum:
  - uji i pijshem per konsum nga popullata etj
  - ujitje ne bujqesi
- Funksione shkarkuese:
  - sherbime higjenizimi, derdhje e ujrave te papastra ne sistemin shperndares urban
  - derdhjet e ujrave te papastra industriale ne industri
  - uje prej drenazhimit ne bujqesi
- Perdorime jo per konsum:
  - hidroenergjitike
  - shmangie te permbytjeve
  - rritje peshku
  - aktivitete argetuese si not apo peshkim

Sikunder begatisë së ujit, Shqipëria gjithashtu zotëron një **legjislacion të bollshëm te ujit**. Legjislacioni parësor përfshin nje sere ligjesh dhe vendimesh te keshillit te Ministrave si:

- Ligji Nr. 8093 datë 21.3.1996 mbi “Rezervat Ujore” (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 8102 datë 28.3.1996 mbi “Kuadrin Rregullator për Administrimin e Furnizimit me Ujë dhe Ujrave të Zeza” (i ndryshuar ne vitin 2005 me ligjin 9352);
- Ligji Nr. 8515 datë 30.7.1999 mbi “Ujitjen dhe Kullimin”; (i ndryshuar)
- Ligji Nr. 9115 datë 24.7.2003 mbi “Përpunimin Mjedisor të Ujrave të Ndotura”;
- Ligji Nr. 8905 datë 6.6.2002 mbi “Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Dëmtimi”;
- Ligji Nr 9587 date 20.7.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit’
- Ligji Nr.9663 date 18.12.2006 “Per koncensionet”
- Ligji Nr. 8681 datë 2.11.2000 mbi “Projektimin, Konstruksionin dhe Mirëmbajtjen e Digave”.

- VKM nr 145 date 26.2.1998 “Per miratimin e rregullores higjeniko-shendetesore per kontrollin e cilesise se ujit te pijshem,projektimin,ndertimin dhe mbikqyrjen e sistemeve te furnizimit me uje te pijshem”
- VKM 682 date 2.11.2005 “Per shpalljen e lumit Buna dhe te teritoreve ligatinore perreth tij “Peisazh ujqor/tokesor i mbrojtur”
- VKM nr 273 date 7.5.2004 “Per miratimin e Strategjise Kombetare te Ujit”
- VKM nr 103 date 31.3.2004 “Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise”
- VKM nr 177 date 31.3.2005 “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisve ujore pritese” etj

Per administrimin e rezervave ujore sipas ligjit 8093 jane ngritur e funksionojne **struktura Qendrore dhe Lokale** qe jane

**Këshilli Kombëtar i Ujit** (KKU) eshte një organizëm kryesor përgjegjës për të përcaktuar konturet e politikave per administrimin e rezervave ujore dhe për të marrë vendimet kryesore . Sipas VKM nr 125 date 2.3.2006 KKU kryesohet nga Kryeministri dhe perbehet nga shtate ministra te lidhur me problemet e mireadministrimit te ujit Detyrat e KKU përshkruhen në nenin 6 të Ligjit të Rezervave Ujore.

Per zbatimin e detyrimeve te ligjit 8093 dhe Vendime te KKU ne Basenet Ujembledhese jane krijuar **Keshillat e Baseneve**.(KBU) Detyrat e tyre jane percaktuar ne nenin 8 te ligjit dhe jane detajuar ne VKKU nr 3 date 19.7.2002.Ato jane autoritete pergjegjese per administrimin e rezervave ujore ne basenet perkatese.

**Problemet e ujërave ndërkuftare** në Republikën e Shqipërisë, trajtohen në bazë të ligjit nr 8093 dhe të VKM nr 124, dt.2.3.2006 ”Per disa ndryshime ne vendimin nr 337, dt 15.07.1999, te Keshillit te Ministrave ”Per krijimin e Komisionit Qeveritar per problemet ujore me vendet fqinje”. Qeveria shqiptare vec Ligji Nr.8849 date 27.12.2001 “Per ratifikimin e “Portokollit per ujin dhe shendetin,sipas konventes se vitit 1992, per mbrojtjen dhe perdorimin e ujerave nderkufitare dhe liqeneve nderkombetare” dhe Ligjit Nr. 9103 datë 10.7.2003 mbi “Mbrojtjen e Liqeneve Nderkufitar” ka miratuar edhe nje sere aktesh te tjera qe trajtojne ujerat nderkufitare sic jane:

“Deklarata per krijimin e Parkut te Prespes dhe mbrojtjen mjedisore e zhvillimin e qendrueshem te liqeneve te Prespes ” (2.2.2000)

Ne 3 prill 2003 u nenshkrua ne Athine ”Marreveshja ndermjet Qeverise se R.SH dhe qeverise se Republikes se Greqise per krijimin e komisionit te perhershem Shqiptaro-Grek per ujerat e fresketa nderkufitare”.Kjo marreveshje 5 vjecare ka hyre ne fuqi ne 21.5.2005 dhe ne prill 2008 ne Tirane u mblodh per here te pare komisioni i perbashket i cili do te mblidhet se shpejti (8.12.2008) ne Janine

Marreveshja ndermjet Qeverise se Republikes se Maqedonise dhe Keshillit te Ministrave te R.SH per mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrueshem te Liqenit te Ohrit dhe pellgut te tij ujembledhes eshte nenshkruar ne Shkup ne 17.6.2004 nga dy Kryeministrat

Marreveshja e Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, mbi problemet ujore dhe statuti i Komisionit Shqiptaro-Malazës për problemet ujore janë diskutuar dhe nënshkruar në komisionin e përbashkët në Podgoricë në 31.10.2001. Në këtë takim u diskutua edhe për problemet e Hidrocentralit të Bushatit si dhe u vendos krijimi i një nënkomisioni të përhershëm për rregullimin e liqenit të Shkodrës dhe të lumenjve Drin e Buna. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi në 13 shkurt 2003

Për administrimin e ujërave sipas rekomandimeve të Strategjisë Kombëtare të Ujit të hartuar nga BCEOM, Konsulencë Inxhinierike franceze dhe të miratuar me VKM nr 273 datë 7.5.2004 Këshilli Kombëtar i Ujit me vendimin nr.5, datë 22.12.1998 **e ka ndare Shqipërinë në 6 basene ujembledhës ku Baseni i Drin-Bunës** me një sipërfaqe të përgjithshme prej 19.582 km<sup>2</sup>, prurje minimale vjetore prej 680 m<sup>3</sup>/sec është baseni më i madh i vendit tonë.

Në territorin hidrografik të basenit të Drin-Bunës nga ana e Republikës së Shqipërisë uishtërojnë aktivitetin e tyre 4 qarqe, 11 bashki dhe 80 komuna aktiviteti kryesor i të cilëve është bujqësia, blegtoaria, pylltaria, minierat dhe me pak turizmi. Baza e zhvillimit ekonomik të kësaj zone është në përgjithësi bujqësia dhe të **ardhurat për frymë janë shumë të ulëta** në krahasim me pjesën tjetër të vendit. Kështu në Qarkun e Kukësit GDP është sa 0.450 e GDP të vendit Në Qarkun e Dibërës GDP është sa 0.497 e GDP të Shqipërisë dhe në Qarkun e Shkodrës sa 0.922 Kjo gjendje e vështirë ekonomike bën që të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas qarqeve Dibër, Kukës dhe Shkodër përkatesisht 43.31 % e popullsisë; 56.59 % dhe 44.93 %

Në këtë basen janë ndërtuar Hidrocentralet e Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejes dhe janë në plan për tu ndërtuar edhe H/C e Skavices dhe Ashtes.

**Problemet me kritike dhe sfidat** me të cilat po ndeshen Autoritetet e ujit në shkallë vendi dhe në basenin e Drin-Bunës sot janë:

-Njohja dhe adoptimi i Direktives 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 23 Tetor 2000, me qëllim ngritjen e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave

-Forcimi institucional i strukturave Qendrore dhe Lokale që merren me menaxhimin e rezervave ujore. Përcaktimi i saktë i rolit të secilës prej tyre dhe i formave dhe menyrave të bashkëpunimit

-Hartimi i inventarit kombëtar të rezervave ujore (Kadastra ujore) dhe pas kësaj hartimi i Planit kombëtar të rezervave ujore dhe i Planeve të rezervave ujore të Baseneve Ujembledhës.

-Përcaktimi dhe zbatimi i mekanizmave financiare që vlerësojnë realisht “mallin ujë”, i mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave në menyrë që Autoritetet e Ujit nën drejtimin e KKKU të veprojnë si struktura unike në nivel Qendror e Lokal.

-Institucionalizimi i marreveshjeve dy e shume paleshe per bashkemanaxhimin e rezervave ujore nderkufitare ne menyre te integruar dhe ne interes te berbashket me shtete fqinje.

Zgjidhja e plote e ketyre sfidave do te behet nepermjet hartimit dhe miratimit se shpejti te Ligjit te ri per rezervat ujore i cili merr ne konsiderate arritjet dhe problemet e deritanishme si dhe adoptimin ne legjislacionin shqiptar te Direktives Europiane te Ujit.

Nisur nga fqinjësia e mire dhe egzistenca e shume ujerave te perbashketa me Greqine, Maqedonine, Kosoven dhe Malin e Zi ne zbatim te konventave dhe marreveshjeve ekzistuese duhet te perfundohen marreveshjet dy paleshe dhe duhet te iniciohen studime te perbashketa komplekse per shfrytezimin e rezervave ujore nderkufitare

Nje pjese e mire e ketyre veprimtarive jane te lidhur me punen dhe perpjekjet qe duhet te bejne strukturat e ujit ne MMPAU dhe Keshillat e baseneve per pregatitjen dhe berjen sa me publike te akteve ligjore e nenligjore te hartuara, ndersa nje pjese ka nevojte te mbeshtetet financiarisht nga buxheti I shtetit dhe nga donatoret deri sa autoritetet e ujit me te ardhurat qe krijojne nga miremanaxhimi i rezervave ujore te fitojne pavaresine ekonomike.

Ju faleminderit per vemendjen dhe i uroj takimit shkembim te frutshem mendimesh dhe rekomandime sa me optimale ne interes e gjithe vendeve qe lidhen me kete basen.

Pellumb ABESHI

Sekretar I Pergjithshem